



ROSA
LIKSOM

e GRUAJA
KOLONELIT



Letërsi e huaj bashkëkohore
Rosa Liksom
Gruaja e Kolonelit
DITURIA

Nga e njëjta autore:

Kabina nr. 6

Rosa Liksom

Gruaja e Kolonelit

Përktheu: Kujtim Ymeri

Shtëpia Botuese DITURIA

Titulli origjinal:
Rosa Liksom
Everstinna

Redaktor: Petrit Ymeri
Paraqitja grafike: Ulinda Selenica

© Rosa Liksom 2017
© Copyright për botimin shqip, DITURIA, 2023



Ky projekt është realizuar me mbështetjen financiare të Komisionit Europian. Ky botim pasqyron vetëm pikëpamjet e autorit dhe Komisioni nuk mund të konsiderohet përgjegjës për përdorimet e mundshme të informacioneve që përmban teksti.



Botuesi falënderon për mbështetjen e
FILI - Finnish Literature Exchange

Shtëpia Botuese DITURIA
Rruga "Frederik Shiroka", Nr. 31, Tiranë
P.O. Box 1441
Tel.: + 355 4 2236 635; Cel.: + 355 692048503
E-mail: sekretaria@dituria.al
www.dituria.al
■ Shtëpia Botuese DITURIA

Faleminderit, H. H.

Në bregun e pjerrët moçalor të një liqeni të madh kërcëllojnë trarët e një barake peshkimi. Varka e vogël prej druri e përmbysur pas murit klith. Kur kthen vështrimin drejt fshatit të vogël, duken shtëpitë e zhytura në errësirë: banorët kanë rënë të flenë. Një perde valëvitet, një dritë vezullon paksa. Dikush rrotullohet nën një kuvertë me lule, dikush në gjumë të thellë kruan njëren pulpë, dikush fle gojëhapur, me pështymën që ngjitet pas bardhësisë së këllëfit, dikush zgjohet i trembur nga një gjumë i lehtë dhe pas një çasti fle prapë, dikush gërhet me intervale, dikush rri ndenjor në anë të shtratit, për të ndezur një cigare tashmë të konsumuar përgjysmë dhe, pasi e ka mbaruar, kruspulloset mbi një oturak të smaltuar, qëndron një çast aty me sytë të mbyllur, pastaj e shtyn enën nën shtrat, kthehet me një psherëtimë mbi dyshekun prej kashte dhe zhytet sërish në kënaqësinë e gjumit.

Vetëm nga një dritare e shtëpisë më të largët mbërrin, e dobët, një dritë. Është shtëpia e gruas së Kolonelit. Parë nga liqeni ngjan një hibrid midis një buni alpin dhe një shtëpize të lashtë finlandeze. Është me dy kate dhe trarët e vjetër tashmë janë të ngopur me ujë.

Në muzgun e zi të fillimit të ditës, akulli depërton midis hapësirave ndërmjet trungjeve të mureve dhe dyshemesë. Gruaja e Kolonelit fut njëren dorë nën veshjen e saj prej lëkure rene dhe shtrëngon rripin e rrobëdëshambrit të saunës, u hedh një shikim të shpejtë çorapeve me lesh deveje dhe pantoflave prej peliçeje që ia mbajnë këmbët ngrohtë në orët e ftohta të natës dhe, duke u luhatur, shkon te oxhaku.

Rregullon mbi rrjetë degët e mëshateknës që ka sjellë Tuomasi.

Zjarri merr me shkrepësen e gjashtë. Kërcitja e drurit që digjet ngjitet lart nëpër oxhak dhe kondensohet në një bllok të bardhë në qiellin e ngrirë.

Bukuria e jetës së shkuar është që nuk kthehet më.

Por asgjë nuk zhduket, kurrë.

Ishte koha e kampit veror të Lotës.^[1] Arrita në Kitilë me korrierën dhe që atje, me plaçkat e mia në sup, eca në këmbë në dendurinë e tajgës deri në një rrip toke që futej midis një liqeni dhe një mënge të një lumi. Të tjerat, vajza e gra të martuara, tashmë ishin për të ngritur çadrat, kështu që u përzjeva edhe unë. Në jug ishte një pellg i sulmuar nga myshku dhe në veri një liqenth i bukur, një pasqyrë uji të pastër e të qetë që lagte një plazh ranor në jug. Unë ua kisha marrë dorën kampingjeve në pyll: në Gjermani babai ishte i pasionuar pas skautizmit, e kështu më vonë e kishte sjellë atë ide në Rovaniem dhe në moshën shtatëvjeçare më kishte futur në seksionin femëror. Me skautet kisha mësuar që personat e respektueshëm ishin të besueshëm, të gjindshëm, të sjellshëm, të bindur, të përgjegjshëm, punëtorë, të guximshëm dhe patriotë.

Ndërsa merrnim këto mësimë të bukura, gjenim kohën të thumbonim njëra-tjetrën, të vinim në shenjë më të voglat dhe të mësonim të jetonim. Unë isha entuziaste dhe kisha pasur fatin të merrja pjesë shumë herë në kampe në Gjermani e kështu kisha mësuar edhe gjermanishten. *Juden raus!* Sa fjalë të bukura më ngjanin në atë kohë, dhe sa të shëmtuara janë tani! Ne çupat e familjes kishim qenë te Lotat e Vogla qysh dhjetë vjet përpara themelimit zyrtar të shoqatës. Imja ishte një familje e Gardës së Bardhë, një model për të gjithë finlandezët.

Te Lotat e Vogla kisha mësuar të shtroja tryezën dhe të bëja centro me grep. Pas Luftës Çlirimtare^[2] mblidhnim copa kockash për të bërë sapun dhe rrënjë qumështoreje për të bërë kafe. Mblidhnim edhe boça pishe: unë mblodha aq shumë, sa që më ngjitën një yll në gjoksin e uniformës. Uniformat i kam ruajtur të gjitha, edhe pse pas paqes na kishin urdhëruar t'i hidhnim. Por çne, unë i rregullova në fund të baules së pajës, asaj aty, në qoshe të dhomës së gjumit.

Në kampin e Lotave në Kitilë kishim si gjenerale gruan e priftit. Ishte e njerëzishme, e zgjuar, e zellshme dhe e saktë. Dhe merrte gjithnjë anën e jetës kundër vdekjes: në këtë kuptim ishte një pacifiste. Na mësoi të bënim një kafe

të mirë, të gatuanim një vakt për një mijë burra njëherësh, t'u shkonim në ndihmë të plagosurve, të mblidhnim kontribute për komitetet lokale të Gardës së Bardhë. Prej saj mësova që gratë duhej të përvishnin mëngët dhe të përpiqeshin deri në vetësakrifikim, se duhej të bindeshin dhe të përgatiteshin mirë për rolin e tyre të ardhshëm si nëna ushtarësh, se nga natyra e tyre burrat ishin tiranë aq sa duhej dhe se duhej të ishin eprorët moralë të grave. Dhe se dashuria ishte një betejë: niste me urrejtjen nga ana e burrit dhe përfundonte me fitoren e tij morale; gruaja duhej të mësonte ta pranonte dhe ta donte burrin e vet me një dashuri të pafajshme dhe të pastër.

Një ditë, në kamp, patëm pak kohë të lirë. Mund të bëje atë që doje. Disa iu vunë leximit të Biblës, të tjerat nisën të këndonin himne të shenjta, të tjera akoma të luanin kaluarthi. Unë mora rrugën drejt kënetës, për të parë si e kishin syrin atë vit manaferrat alpine, a kishin nisur apo jo të nxirrnin lule. Po çaja mes shkurnajës së dendur të verrave, kur befas terreni i thatë nën këmbë u vithis nën këmbët e mia dhe bota u luhet më shumë se po të kisha qenë ulur në një shilarth. Më doli para syve një kënetë e madhe, e mrekullueshme. Nisa të kërceja si një drenushë e re nga njëri plis myshku në tjetrin, duke lëshuar klithma si një e pushtuar nga demoni lestadian.^[3] Me piruetat e mia shpëtova pa u rrëzuar në ujë dhe nga rropullitë e tokës u ngritën aroma aq të forta, sa që m'u desh të kapesha pas degës së një pishë të shtrembëruar, që të mos më binte të fikët. Kisha në kokë të gjitha ngjyrat e mundshme e të përfytyrueshme dhe shikoja dritëra, hije dhe pasqyrime të çdo lloji. Pishat, me koren e tyre ngjyrë kafeje, fëshferinin; bredhat, të veshur me likene, gjëmonin; shkëmbinjtë jehonin dhe një tufë lejlekësh klithte atje lart në qiell. Ndieja ethe në trup dhe më dukej sikur koka nuk ishte më mbi qafë dhe qeshja e shfrenuar. Ndërkohë shkoja përpara, duke ngritur stërkala me këmbët e zbathura dhe duke ndier në gishtat e mëdhenj frymëmarrjen e acartë të kënetës. Tashmë isha e lagur deri në brez dhe herë pas here zhytesha e gjitha në gjithë atë llum barërash dhe lymi. Të ngjitura mbi flokë kisha presje dhe fosile, por asgjë nuk më ndalonte dhe nuk mendova më për lulet e manaferrave alpine: isha aq e lirë, kaq e plotë, kaq e pakufizuar, sa që ndieja limfën të më rridhte brenda dhe mendova: në qoftë se vdekja vjen të më marrë tani, e pres krahëhapur. Isha forca tejtokësore dhe vetë bukuria nga koka te këmbët. Koleopterë, larva, miza kali dhe ndonjë mizë drerësh gumëzhinin, bretkosat kuaknin mikpritëse dhe lejlekët bërtisnin grykëshqyer sikur t'i kishin qëlluar. Nuhatja më zvarriste në jug dhe të prekurit në perëndim dhe, tek vinte mbrëmja, kur, tashmë pa një fije force, ndalova dhe rihapa sytë, nuk dija më se ku ndodhesha. Nuk u tremba. Vështrova këmbët e

përbaltura. Kishin shirita gjaku të kuq të errët; ishin gërvishtur nga bimë liqenore me anët e tyre të mprehta dhe ishin pickuar nga insektet. E kisha të gjithë trupin të spërkatur me baltë dhe isha bërë e zezë si një pishë shekullore e djegur në zjarr. U preka në mes të këmbëve, sepse aty ndjeva një djegie të çuditshme dhe dora preku diçka rrëshqitëse që varej. Ngrita kindin e fundit dhe kuptova që ishte një shushunjë; më thithte gjakun nga njëra buzë e seksit. Duhej të kishte qenë aty duke thithur për një copë herë, aq e ënjtur sa ishte. E shkëputa pak nga pak dhe e flaka në shqopën e pyllit. Isha e mbaruar, kështu që u plandosa mbi një shtrat torfe dhe pikërisht atëherë pashë në një vagëllim botën si do të mund të ishte një ditë. Një botë e gruas dhe burrit së bashku, lojë dhe dashuri, një shpërthim ëmbëlsie dhe kënaqësie, ku të gjithë ishin të mirë me njëri-tjetrin dhe i bashkonte të qenët njerëz, siç ishin, një botë pa mirësi dhe ligësi, ku nuk kishte fjalë, vetëm ndjesi.

Dhe me këtë vizion të mrekullueshëm më zuri gjumi. Torfa më zhvendosi gjatë gjithë natës dhe, kur u zgjova, hëna që po binte ishte zbehur dhe unë kisha prekur bregun e liqenthit, pisë i zi. Vështrova poshtë në atë humnerë pa fund dhe në sipërfaqen e tij vezulluese pashë të shkonte e të vinte pasqyrimin e reve e pastaj edhe veten. Fytyrën e qetë të një gruaje të re dhe të bukur dhe një shtizë ku ngrihej flamuri i Lotave, që valëvitej në anën e gabuar. U rrotullova dhe pashë pak më tej, përkrah bregut, kampingun tonë. Të gjitha flinin të qeta e të lumtura. Shkova pa u ndjerë në lëndinën e zjarrit të përbashkët, grumbullova degë, ndeza zjarrin me një kore mështekne dhe përgatita një ibrik të madh kafeje. Sa të kënaqura ishin të tjerat, që në të zgjuar gjetën secila një tas të mirë kafeje të ngrohtë të bërë gati! Pas kampit të Kitilës isha aq entuziaste, sa që askush nuk më ndalte dot më. Në kokë më zienin vetëm Lotat dhe Garda e Bardhë. Të dyja bazoheshin në idealet gjermane dhe në ndjesinë e epërsisë, përveç rusofobisë dhe idesë që detyra jonë ishte të bashkonim popullsitë e gjuhës finlandeze në një Finlandë të vetme. Por në bazë të gjithçkaje ishte trinia e shenjtë: familja, feja, atdheu. Për mua ishte e përkryer. Iu futa punës për t'i konvertuar të gjithë në kultin e Gardës së Bardhë. Nuk e mbyllja gojën kurrë, as në tryezë. Nëna s'dinte ç'të na bënte mua dhe fjalimeve të mia, sepse thellë-thellë ajo mbante anën e Finlandezëve të Rinj, sikurse babai, kur ishte i ri. Më pas qe festa e Lotave në Kemi dhe unë vdisja nga dëshira për të shkuar atje. Në fillim mamaja tha jo, por pastaj, kur motra ime Rebeka premtoi të kujdesej për mua, u zbut. Imitova Rebekën dhe veshi uniformën e Lotave dhe atëherë mbajta fjalimin tim të parë, të shkurtër: thashë që atdheu ishte një vlerë për të cilën asnjë sakrificë nuk ishte e kotë. Festa

kulmoi me një paradë në të cilën përveç Lotave parakaluan ushtarët e Gardës së Bardhë. Sa tërheqës ishin me ato uniformat e tyre! Bukuria dhe harmonia e paradës e shtuan te ne dëshirën për të luftuar dhe na nxitën për luftën e afërt kundër rusëve.

Babai im Juho kishte lindur në një prej familjeve më të pasura fermere në Kitila, që ishte edhe e vetmja familje tregtarësh në atë vend. Qe i pari agronom i Kitilës. Gjyshi im nga babai, gjyshi Fransi, vdiq para se të lindja unë dhe gruaja e tij, gjyshe Elve, ishte një sami e pastër. Arriti plot njëqind e një vjeç. Gjyshja nuk ishte rritur në një familje të mjerë peshkatarësh: njerëzit e saj ishin rritës renash dhe ajo, kur qe fëmijë, hipte e zbriste nëpër kodrina me një slitë të tërhequr nga rena si një princeshë e vërtetë. Në zemër të dimrit gjyshja Elve hidhte stërkala qumështi rene drejt diellit, që ai të sillte dritë dhe ngrohtësi pas errësirës dhe të ftohtit. Pastori i Kitilës e shante dosë të etur për mish dhe bushtër të zotëruar nga Satanai, sepse ajo nuk ua fërshëllente fare predikimeve të tij shumë serioze dhe shumë të mërzitshme. Mua, që isha kanakarja e saj, gjyshja Elve më mësoi goxha gjëra për kohët e shkuara. Mamaja ime Iita kishte lindur në Helsinki në një familje aristokratike të gjuhës suedeze. Gjyshja Hiltrud, nëna e saj, ishte mikeshja e besuar sekrete e gjeneralit Bobrikov dhe gjyshi im nga nëna Tomas ishte një sipërmarrës i njohur, që bëri para me thasë e pastaj i humbi të gjitha. Nuk kam kujtime për ta, sepse vdiqën përpara se të vija unë në botë.

Për krizën botërore të tregjeve dhe për depresionin ekonomik që filloi në Nju Jork nuk do të kisha mësuar kurrë gjë, në qoftë se ajo nuk do të na i kishte thyer hundët, kur shtëpia e familjes në portat e Kitilës u dënua me vdekje. Pas vdekjes së gjyshërve, u ble nga xhaxha Mati, që i ishte dashur të lëshonte kambiale. Kreditori ishte një farë Paksuniemi, fermeri më i pasur në vend dhe ish-shok shkolle i babait. Kur kishte ardhur çasti për të paguar, xhaxha Mati kishte mbetur trokë dhe ky pasunari Paksuniemi u hodh e tha që i duheshin nja dy dhoma më shumë për në verë e prandaj po i merrte për shlyerjen e borxhit. Unë pikërisht në atë periudhë kisha bujtur te xhaxha Mati dhe një ditë isha aty të shkruaja në ditarin tim dhe të thurja ca vjershëza, duke gjerbur një çaj me gjethe mjedre, kur mbërriti Paksuniemi me punëtorët e tij. Në mesditë kishin sharruar mirë e bukur dy dhomat e prapme dhe pasdite i ngarkuan trungjet në një qerre të tërhequr nga një kalë. Vila ku kishte lindur babai, shtëpia e tij e adhuruar, mbeti aty e përlotur, e dhunuar, e poshtëruar. Xhaxha Mati tha që tashmë paratë i kishin vetëm të pasurit dhe kush dinte të punonte

zvarritej rrugëve i papunë, sepse punën duhej të shkonte ta kërkonte larg dhe se varfëria dhe mundimet nuk mjaftonin: që shtuar edhe zia e bukës vite me radhë, kështu që feramat përfundonin në ankand, fushat korreshin nga borxhet dhe gazetat ishin të mbushura me njoftime për lëniesh peng.

Pikërisht atëherë m'u poq mjaft qartë në mendje ideja që edhe në Finlandë ishte nevoja për një prijës të fortë, për një që të dinte të thoshte jo dhe të dëgjonte zërin e të varfërve dhe të punonjësve të shtyrë në periferi të tregut. Komunistët nuk ishin në lartësinë e duhur. Mjaft të shikoje xhaxhain tim Mati, që ishte I Kuq. Në vend që të merrte sëpatën dhe të mbronte gjënë e vet, rrinte aty e qante. Kështu që vendosa që atë lojën e Lotave ta luaja deri në fund. Më shumë akoma: kuptova që për të ringjallur Finlandën duhej një mënyrë më energjike mendimi dhe veprimi, më e qartë, më e thjeshtë.

Dhomat e vilës magjepsëse të xhaxha Matit morën fluturimin. Më pas, kur ekonomia u rimëkëmb dhe nga zija e bukës u kthyem në bollëk, xhaxhai ndërtoi të reja, më të rehatshme se të vjetrat dhe vuri te të dyja nga një sobë me qyngje. Mua xhaxha Mati më pëlqente dhe nuk më interesonte fare nëse ishte I Kuq. Kishte të njëjtën gojë si babai, por nga karakteri ishte më i plogët. Meqenëse e vogël isha një shejtan, njëherë më mbërtheu, më kapi nga krahu dhe më çoi në pyll. Ishte verë dhe mushkonjat ishin të etura për gjak. U futëm në një pellg të mjelmët. Nuk e dija ku po më çonte, por në krah të tij nuk kisha frikë. Më pëshpëriti se nuk duhej të shkoja kurrë në një kënetë si ajo, sepse njerëzit dhe kafshët përfundonin të mbytur dhe sepse gëlonin nga rreziqe të tilla si murtaja e zezë, koleopterët që të pickonin, duke të injektuar gjak të keq në damarë dhe parazitë të tuberkulozit e pastaj në këto vende shkonin të fshiheshin kriminelë dhe vrasës pa asnjë shpresë dhe kishte fëmijë të vrarë dhe fetuse të padëshiruara. Nisa të qaja. Xhaxhai më qetësoi, duke më përsëritur që mund të rrija e qetë, por ta mbaja mend gjithnjë ç'më kishte thënë.

Unë nuk e harrova dhe qysh atëherë gjithmonë që kaloja para një kënete - dhe në Laponi ka me tepri - ia mbathja, duke vrapuar si e çmendur. Kur u bëra më e madhe, po të shikoja ndonjë, ndaloja dhe qëndroja buzë saj ta sodisja, sepse dëshiroja ta mposhtja frikën. Pak nga pak ia dola mbanë dhe fillova t'i doja të gjitha kënetat, pa le të ishin të vogla a të gjera e të ndryshme, me myshk torfe apo pa myshk torfe, me drurë apo pa drurë.

Kur linda ishte kohë urrejteje.

Kur u bëra grua, ishte koha e urrejtjes dhe e hakmarrjes.

Ditën që babai dha frymën e fundit te ne kishte qenë Koloneli. Unë isha strukur pas derës, për të përgjuar atë që thoshin ai dhe babai. Koloneli kishte thënë që, kur Hindenburgu të kthente këmbët nga dielli, pushteti do t'i kalonte Hitlerit pa zgatur shumë, sepse prapa ishin paratë, dhe që Hitleri do të risillte punë dhe pasuri në Gjermani, do t'u kthente krenarinë gjermanëve dhe do të ngadhënjente mbi botën. Ne jemi miq të gjermanëve, kishte komentuar babai, dhe, duke qenë nën krahun e tyre mbrojtës, do të çlirojmë popujt e gjirisë finlandeze nga kthetrat e rusëve dhe ta bashkojmë në një Finlandë të vetme të gjitha tokat që Lënroti ka kënduar te *Kalevala*, deri në Urale. Koloneli ia kishte kthyer se asnjë finlandez nuk dëshironte që bota të na konsideronte vendi baltik më në veri. Sigurisht, ishte në një mendje babai, pas pak do të shpërthejë lufta dhe ne kemi minierat e nikelit të Petsamos, prandaj s'kishte asgjë për t'u trembur.

Që fëmijë kisha nuhatur që midis babait dhe Kolonelit kishte një marrëdhënie të veçantë. Njëherë mamaja tha pa dashur që në Gjermani, në kampin e *jegërve*⁴¹, Koloneli e kishte shpëtuar babain, që ishte përpjekur të varej pas një varg gjërash që kishin ndodhur.

Kur po binte mbrëmja Koloneli iku në shtëpi dhe babai më kërkoi të bëja sauna me të, meqenëse isha bija e tij e parapëlqyer. Herë njëri herë tjetri hodhëm ujë mbi gurët e përflakur si dy të çmendur, unë i fshikullova kurrizin me një tufë degësh dhe, kur dolëm, qëndruam atje, duke gjerbur birrën e bërë në shtëpi. Babai më tregoi se si ai dhe mamaja kishin shkuar në udhëtimin e martesës në Kopenhagen. Me sa duket në Kitilë në atë kohë nuk ishte dëgjuar kurrë që ndonjë çift i ri të shkonte për muajin e mjaltit jashtë. Përkundrazi, për familjen e nënës, që bënte pjesë në elitën intelektuale, ishte një lloj rregulli. Kështu që gjyshërit e Helsinkit i kishin inkurajuar, kurse ata të Kitilës i kishin kundërshtuar, sepse me sa duket qenë të fiksuar pas fesë dhe ushtronin lestadianizmin konservator. Të sapomartuarit kishin kaluar natën në një pension në qendër të Kopenhagenit dhe kishin nisur të shpenzonin pa e

rrudhur dorën si një mbret e një mbretëreshë. Deri sa kishin mbetur ngushtë për para. Atëherë babai i kishte telefonuar motrës në Rovaniemi dhe i kishte kërkuar t'i dërgonte ca. Ajo i ishte përgjigjur se nuk do t'i dërgonte asnjë qindarkë dhe se e konsideronte një barbari që ai, agronom dhe drejtor i shkollës profesionale agrolektorale, ishte martuar me një nxënëse. Kështu babai kishte formuar të vetmin numër telefonik që ekzistonte në Kitilë, atë të shtëpisë së familjes së vet, dhe fati kishte dashur që t'i përgjigjej xhaxha Mati. Xhaxhai i kishte nisur menjëherë paratë, por posta ishte e ngadalshme. Administratori i pensionit kërkonte qiranë dhe nuk kuptonte, kur babai i shpjegonte, latinisht: *Pecunia venit*. Prandaj kishte thirrur policinë dhe babai kishte përfunduar në burg. Mamaja, që kishte shkuar në pastiçeri të blinte ca ëmbëlsira, kur ishte kthyer, nuk e kishte gjetur. E alarmuar, kishte pyetur pronarin e pensionit, me një suedishte të përkryer, se ku ishte burri i saj. Tjetri kishte mërmëritur diçka në danisht, por ajo nuk kishte kuptuar gjë dhe kishte qëndruar një javë e mbyllur në dhomë, duke qarë, duke u ushqyer me pasta dhe duke pirë shampanjë, sepse nuk kishte gjë tjetër. Ishte e bindur që babai kishte gjetur një grua tjetër dhe ia kishte mbathur me të. Pastaj, një mbrëmje të errët, ishte rishfaqur me një tufë bankënotash në dorë ndërsa gruaja e tij ishte shtrirë në shtrat e mbërthyer nga dëshpërimi. Sa të hapje e të mbyllje sytë gjithçka qe rregulluar. Si kujtim të udhëtimit kishin blerë një karrocë fëmijësh, nga ato të lartat, të stilit viktorian, sepse kishin marrë vesh që mamaja priste fëmijën e parë, domethënë Rebekën. Edhe unë i kalova muajt e mi të parë në atë karrocë dhe prej andej kam qenë e pranishme në shfaqjet fantazmagorike të agimit boreal në caqet e qiellit lapon në mes të dimrit dhe, në ditët e nxehta verore, kam parë bardhësinë dhe kaltërsinë e qiellit. Aty jam ndjerë e plotë, e përkryer.

Me të mbaruar tregimi për muajin e mjaltit, bëmë një tjetër rrugë për në sauna dhe pastaj kaluam nëpër oborr, për të shkuar drejt pallatit të vogël të mësuesve. Mu në mes të oborrit babai u përplas në tokë, tamam para syve të mi. I shtrirë atje, me sytë të perënduar, më shtrëngoi dorën me forcat e fundit që i kishin mbetur dhe më tha se isha engjëlli i tij i zi. Pasi i gurgulloi nga goja një shirit i hollë gjaku, vazhdoi udhëtimin e tij në tokën e hijeve. Qe një goditje prej së cilës ende nuk e kam marrë veten. Për shumë vite mendoja se vdekja e babait ishte hakmarrja e perëndive ndaj meje, sepse kisha dëgjuar fshehurazi bisedat e burrave.

Pas vdekjes së babait, mund ta kishte zënë xhaxha Mati vendin e figurës atërore; përkundrazi e zuri Koloneli. Xhaxhai ishte shumë i ndrojtur dhe nëna

kishte nevojë për një burrë që të kishte aftësitë e babait tonë. Nëna na ka rritur në frikë. Para se të tundte rripin, thoshte gjithnjë se ai që kursente drurin i urrente fëmijët e vet dhe pastaj na pyeste a na kishte arritur dhimbja në tru. Ne duhej të përgjigjeshim po. Dhe ishte e vërtetë: kujtimet na mbeteshin në tru dhe dhimbja mbetej në trup. Mamaja na godiste sa na e përgjakte prapanicën e kështu u bëmë frikamane. Trembesha aq shumë, saqë disa herë gëlltisja rruazat e varësës ose haja kindin e fundit apo kafshoja dorashkat. Njëherë Rebeka më tha ta vija gishtin e vogël të këmbës mbi një trung, që të ma guduliste me sëpatë. Unë u binda dhe menjëherë gishti im i vogël fluturoi pas murit të depos të druve. Mamaja në fillim na hyri në dru të dyjave e vetëm pastaj më fashoi këmbën. Hemorragjia që aq e fortë, saqë pata ethe dhe mbeta dy javë në shtrat gjysmë e vdekur. Kur e mora veten, mamaja më tha që ajo që nuk të vret të bën më të fortë. Ishte një grua e pakët, e brishtë. Unë isha më e gjatë dhe më e fortë se ajo qysh kur isha dhjetë vjeç, megjithatë duhej t'u nënshtrohesh metodave të saj edukuese. Betohej që do të na bënte ne dy bija të ndershme dhe të virtytshme. Te një vajzë, thoshte gjithmonë, dhe te një grua duhej të shikohej fryma hyjnore. Mamaja ishte thellësisht fetare, dhe ishte gjithmonë e zemëruar: kishte frikë për ne dhe kjo te një i rritur ushqen një lloj inati të vazhdueshëm. Shprehja e saj e parapëlqyer ishte: ajo që nuk është e nevojshme është mëkat. Sigurisht, nuk kishte të bënte me të, por do të thoshte që ne vajzat nuk duhej të bënim asgjë që sipas saj nuk ishte me vend. Po ta bënim, na takonte një e përkëdhelur nga zonja Degë e Mështeknës. Një ditë vere, kur isha pak më shumë se katër vjeçe, isha shtrirë të shijoja diellin mbi çatinë e qilarit të xhaxha Matit në Kitila. Hoqa pantallonat dhe nisa të prekja veten. Nëna, duke kaluar andej, më pa. Dhe më ulëriti se po bëja një gjë shumë të shëmtuar dhe, po ta bëja prapë, Zoti do të më ndëshkonte dhe do të bëhesha e verbër. Unë natyrisht u tmerrova dhe fillova të qaja. Kur qeshë më e madhe, më bëri një goxha predikim: gjithçka që ka të bëjë me trupin, tha, e ndot shpirtin, e pengon arsyen të grumbullohet në tru dhe çon në çmenduri. Që kur arrita t'i shpëtoja shikimit të saj, kam bërë ç'ishte e mundur për t'i shkelur rregullat e saj.

Babait i bëmë një goxha funeral dhe unë mbeta vetëm. Bota ime u bë e zbrazët dhe e zymtë. Mendoja me vete: ose do të vdes, ose do të eci në rrugën që përshkoi babai im.

Verën pas funeralit u bë festa e racës finlandeze në Oulu. I thashë mamasë që kjo ishte thirrja e këmishave të zeza të Lapuas^[5] në frymën e babait, por ajo ma

ktheu që të mos ngatërroja kot babanë tim, sepse unë në festë nuk do të shkoja. Por Rebeka do të shkojë, këmbëngula. Mamaja që e palëkundur. Unë nuk ju dërgoj ju qurravece të tërbuara të bëni aheng me fashistët, tha, edhe patriotizmi ka një kufi. Rebeka qëndroi në shtëpi, unë ia mbatha.

Treni më shkarkoi në mëngjes në stacionin e Olulut. Kambanat e kishës shënonin orët, orkestra luante një marsh përpara hyrjes kryesore të stacionit dhe gjithandej kishte aromë hareje. Parada dhe fjalimet zyrtare ishin parashikuar në mesditë para bashkisë. Pasi pashë ca përreth iu vura pas një grupi burrash të drejtuar për te sheshi qendror. Pastaj u ula te shkallët e një pallati që shihte nga sheshi dhe nxora nga çanta mëngjesin e mbështjellë me letër. Pranë meje erdhi të ulëj Ritva Ramevaara, një ish-shoqja ime e shkollës. Më tregoi se ishte E Kuqe dhe po shkonte në kampin e Rinisë Komuniste. Iu përgjigja që atëherë kishim shumë gjëra të përbashkëta, përveç së kaluarës: të dyja ishim të magjepsura nga forca dhe të përvëlura për rebelimin dhe për dëshirën për ndryshime revolucionare. Për mua demokracia ka mbërritur në pikën fundore, i thashë, dhe Europa e re ka nevojë për një prijës të fortë e ndoshta edhe ti mendon si unë. Ritva pohoi me kokë. I ofrova një sanduiç, kaluam në revistë të gjitha të rejat dhe thashethemet e pastaj secila shkoi në udhën e saj. Unë eca me hap të lehtë drejt podiumit kryesor. Dielli shkëlqente i akullt nga lindja dhe ishim shumë. Pikërisht në mesditë arritën dy automobila të mëdhenj të zinj që ndaluan prapa podiumit të oratorëve. Prej njëres nga ato makina gjigante zbriti, me lëvizje të ngadalta dhe solemne, mbreti i lapistëve, Vihtori Kosola. Të gjithë ne e shikonim të heshtur, kur po ngjitej në podium. Tek ai kishte diçka nga Paavo Nurmi dhe nga Tauno Palo^[9] e një çikë nga Musolini. Të ecurit ishte i Paavos, sytë dhe vështrimi ishin të Taunos, të Musolinit ishin gjestet prej fashisti italian dhe fjalimi i tij më depërtoi si një thikë e sapomprehur. Mbeta e magjepsur nga fjalë të tilla si “raca”, që në mendjen time lidhej menjëherë me trashëgiminë e gjakut dhe me krenarinë e vajzave më të mëdha, “heroizëm”, që për mua kishte të njëjtën frymë të legjendave të shenjtorëve dhe të njëjtën bukuri të pastër të ushtarit spartan, dhe “asketizëm”, për të kujtuar se nuk ishin paratë dhe pasuria që jepnin lumturi, por një besim i fortë te Zoti dhe një atdhe i gjerë dhe i lulëzuar. Ndjenja kombëtare e finlandezëve, tha Kosola, ishte e dobët në krahasim me atë të gjermanëve, që ishin të zgjuar dhe kureshtarë, dhe ishte detyra jonë ta mbushnim këtë hendek e pastaj t’i kalonim. Kur fjalimi mbaroi, isha nën pushtetin e magjisë dhe gjithçka më ngjante e mundur. Sikur midis Kosolas, meje dhe të gjithë publikut mjaftonte vështrimi për t’u kuptuar: kishte një

sintoni të përkryer. Bleva në tezgë një këmishë të zezë dhe e vasha mbi uniformën e Lotave. Pas pak orkestra ia mori një marshi, parada shtrëngoi rreshtat dhe u nisëm me të shpejtë drejt selisë së Gardës së Bardhë ose asaj të zjarrfikësve, nuk më kujtohet më. Dhe unë që marshoja, plot pasion e shpresë, isha aty e vetmja vajzë midis atyre krerëve barkmëdhenj familjesh. Bërtisnim se deti Baltik do të bëhej deti gjermanik, kërkonim një sistem me një parti sipas modelit gjerman, për të luftuar më mirë bolshevizmin, ishim të bindur për nevojën e asgjësimit të lëvizjes sindikale dhe të formimit të një organizate të vetme të punës në të cilën sipërmarrësit dhe punëtorët do të bënin bashkërisht të mirën e Finlandës, e gjëra të tilla.

Pas marshimit, kreu i divizionit tonë më propozoi të shkoja me të në shkollën aty afër, kështu do të më bënte të shihja një fotografi të Mareshallit^[2], që me siguri nuk e kisha parë kurrë. Naive, e ndoqa pas, por kur arritëm në shkollë, më shtyu brenda depos së palestrës dhe më përdhunoi.

Mbeta aty për tokë: nuk arrija të lëvizja. Isha e ngrirë nga kërthiza e poshtë dhe më ishin bllokuar këmbët por edhe gjuha. Sikur të më kishin ngulur në kokë një gozhdë të madhe të ndryshkur. Vetëm kur u bë natë arrita të lëvizja gishtin e vogël aq sa mjaftonte për të shkarkuar tensionin muskolor dhe pak nga pak dola këmbadoras nga ndërtesa.

U ktheva në shtëpi e dërrmuar dhe tërbimi i mamasë u shua sapo pa se në ç'gjendje për të ardhur keq ndodhesha. U tremb për vdekje, mendoj se mos kisha marrë murtajën ose tuberkulozin. E zbehtë, në ankth, me kokën që më pëlçiste nga dhimbja, endesha mes kamaroshave, sendeve të zbukurimit prej bronzi dhe vazove kineze prej balte dhe thosha se thjesht më kishte zënë një grip i keq që më kishte këputur. Funksionoi, por e dija që duhej të ikja nga shtëpia sa më shpejt, sepse pas atij përdhunimi ndjehesha vërtet e neveritshme. Vendosa të bëja si kishte bërë Gjermania dhe planifikova një veprim të befasishtëm: do të martohesha me të parin individ të seksit mashkullor që do të më dilte përpara. Mendoja se, duke u martuar dhe duke u larguar nga shtëpia, do të kisha flakur tej të kaluarën me një goditje të vetme, si kishte bërë Fyhreri në pranverën e vitit '34.

Ishte koha e vjeljes së patateve dhe unë isha te Laako-nenët, për të shkukur zhardhokët. Aty pashë një tip që jetonte në një nga ata fshatrat rreth liqenit. Nuk ishte as i shëmtuar, as i bukur, s'ishte asgjë fare. Emrin nuk ia mbaj mend, por po e quaj Kauno. Kishte këmbë të shkurtra dhe bythë të madhe. U martova me të dhe shkova të jetoja në shtëpinë e tij, në fermë. Si trashëgim më takoi pasqyra e madhe e vjetër me kornizë të praruar, që babai e kishte blerë në

Ingria, dhe pianoja e mamasë, tashmë aq e çakorduar, saqë nuk mund të luaje më me të, edhe pse unë luaja megjithatë. Martesa zgjati nga vjeshta deri në pranverë. Jo se ky tipi ishte edhe aq i keq, por kishte një të metë: ishte aq i lidhur pas tokës sa të na zhyste atje deri në grykë. Unë isha e bindur se mund të aspiroja për diçka më shumë në jetë: vetëm ta mendoja, roli i amvisës ishte tepër banal për mua. Vendosa ta prishja, në fund të fundit ajo martesë ia kishte arritur qëllimit.

Kur kërkova divorcin, Gjermania po divorcohej nga traktati i paqes i Versajës. Ashtu si Gjermania, edhe unë kërkova sërish instinktët e mia natyrore. Por të merrje divorcin nuk ishte gjë e vogël dhe unë mundesha vetëm të prisja. Jeta ime hiqej zvarrë në pritje dhe ndërkohë harbimet e Lëvizjes Lapiste dhe trashëgimtares së saj, Lëvizjes Patriotike Popullore^[8], nisën të qelbeshin si një pirq plehu. Shkoja në selinë e shoqatës sportive të fshatit dhe dëgjoja burrat të hartonin lista të banorëve që duheshin hequr qafe. Përgojonin hebrenjtë që, me puron e tyre në gojë, i kërkonin azil Finlandës, edhe pse mund t'i lejonin vetes duhan të kushtueshëm. Jo, asnjë azil për ta, te ne. Po hebrenjve të varfër që kërkonin azil për arsye ekonomike dhe humanitare? Asnjë azil as për ta. Për asnjë hebre. Le të shkonin në kampet e përqendrimit.

Pika që e bëri kupën të derdhej qe historia e Gronroosit, shkrimtarit. Gronroosi mbante farmacinë e fshatit, e ngritur në shtëpinë e tij, dhe shkruante idile rustike për një revistë femërore. Unë shkoja tek ai të shkëmbeja dy fjalë një herë në javë. Ndonjëherë flisnim për librat, ndonjëherë për jetën. Më thoshte se në botë ka vetëm një problem filozofik vërtet serioz: vetëvrasja. Qysh atëherë vazhdoj ta mendoj.

Një mëngjes Kaunoja shkoi në stallë dhe dëgjoji të vinin nga depoja e plehut rënkime të shoqëruara nga një cijatje e çuditshme. Mendoi se ndoshta një derr kishte përfunduar aty gabimisht dhe bëri të hapte portat, që ta linte të dilte, por pastaj i ra në të që mbi pirqun e plehut ndodhej një thes prej kërpi dhe që zhurmat arrinin prej diçkaje që lëvizte aty brenda. E hapi dhe pa që në thes ishte Grosroosi. Nxitoi në shtëpi të kërkonte ndihmë dhe, natyrisht, unë vrapova me shishen me kamfor. Ç'pamje e tmerrshme! Je gjallë, e pyeta. Ishte gjallë, por mbeti sakat gjithë jetën. Me mykën e një sëpate, ata të Lëvizjes Patriotike Popullore ia kishin bërë si llapa dorën me të cilën shkruante. Ky episod bëri të më hipte gjaku në kokë, në atë pikë sa i hipa trenit dhe shkova në Lapua te Vihtori Kosola. I zoti i shtëpisë nuk ishte: ndodhej në selinë e "Suomen Lukko"^[9]. Kur arrita aty, e gjeta tepër të angazhuar të projektonte t'i jepte Finlandës dorën përfundimtare, të fundit të gëlqeres. Mendova: Vihtori

është njeri i mençur dhe i urtë; ai do t'u japë fund këtyre idiotësive. Para së gjithash i thashë se bijë e kujt isha, sepse ai dhe babai qenë njohur gjatë Luftës Çlirimtare, e pastaj i tregova se ç'i kishte ndodhur mikut tim Gronroos. Iu betova se nuk ishte komunist, ishte vetëm një shkrimtaruc i padëmshëm me mitin e fshatit. Kosola dëgjoi i vëmendshëm e pastaj më tha se e kisha zemrën tepër të butë dhe që duhet të bëhesha pak më e fortë, sepse ishin pikërisht ata negrit që nxinin letër që i hapnin rrugën komunizmit. U largova e dëshpëruar dhe vendosa të mos merrja më kurrë pjesë në veprimtaritë e fashistëve finlandezë. Nuk kisha dëshirë të marshoja bashkë me budallenjtë, por atje ku lulëzonin gjykimi dhe urtësia.

Kosola mund ta mbante për vete fashizmin e tij alla-Musolini, që nuk kishte asnjë thërrime klasi. Unë mora një udhë tjetër, në të njëjtin drejtim, por më të pastër. Më erdhi në mendje ç'thoshte babai: që nga Gjermania vinin vetëm gjëra të mira. Prej Luterit - feja, nga Pauligu - kafeja dhe unë shtova nacionalizmin që vinte nga Fyhreri. I hoqa sytë nga fashistët finlandezë, të bërë me lëndë të parë skarco dhe fillova të vështroja gjithnjë e më shumë nga Gjermania. Në shenjat e para të pranverës Rebeka erdhi të më shihte në fermë dhe u strukëm në papafingo, në dhomën që shihte nga jugu. Lexuam me zë *Majn Kampfin*, unë asaj dhe ajo mua, dhe u tërbuam si dy çupka të ngazëllyera. Herë-herë Kaunoja vinte të trokiste lehtësisht në derë. Më lini të hyj, thoshte, dua të jem edhe unë. Dhe unë i bërtisja të ikte, sepse po bisedonim për punë grash. Rebeka më lexonte që Fyhreri kishte urdhëruar të ndërtohej një rrjet kampesh përqendrimi shumë të bukur dhe funksionalë, ku do të mbylleshin të papastrit. Në atë kohë kampet e këtij lloji ishin një gjë normale në të gjithë botën. Ishin eksperimentuar dhe ishin vlerësuar si një sistem i efektshëm dhe funksionues si në Lindje, edhe në Perëndim. Unë mendoja që, meqenëse njerëzimi përparonte, nazistët nuk do të kishin kopjuar ato kampet barbare, brutale që kishim ne gjatë Luftës Çlirimtare dhe që zgjatën për një copë herë të mirë edhe më pas. Gjermanët ishin një popull i qytetëruar dhe e dinin sa të rëndësishëm ishin ushqimi i mirë, higjiena e gjithë të tjerat. Unë kisha parë një gjerman për herë të parë me sytë e mi në fillim të qershorit të vitit 1918, në fund të Luftës Çlirimtare, kur trupat gjermane ishin zhvendosur nga Helsinki në Oulu, për të matur tokat që i quanin pronë të tyre. Atëherë Finlanda ishte një koloni gjermane dhe atë verë familja ime jetonte në Oulu për shkak të punës së babait. Unë dhe Rebeka ishim në stacion, të krekosura përkrah tij në pritje që të arrinin mysafirët aq të dëshiruar. Mbaj mend kapelën prej plisi të zi të babait, erën e xhaketës së tij verore prej

puplini, përparësen e bardhë të Rebekës, që ia kisha zili. Një bandë ushtarësh gjermanë u ra daulleve dhe melodia e marshit jehoi në ditën e ndritshme verore, ndërsa mbi shina përhapej buja gazmore e njerëzve dhe kutërbimi i bajgave të kuajve. Prej trenave u derdhën qindra gjermanë: oficerë, komandantë, burra me biçikleta dhe ushtarë që kishin mbi trup një aromë aq të sheqerosur, sa që më erdhi dëshira t'i lëpija. Dikush kishte në sup një thes me miell gruri, kush një thes me oriz. Një ushtar erdhi drejt e tek unë, më mori në krahë, më puthi në faqe, pëshpëriti në veshin tim të vogël sekrete misterioze gjermane, më përkëdheli kaçurrelat e zeza dhe më mori mbi supet e veta. Unë u dashurova menjëherë me atë teuton me vështrim gazmor, sepse babai nuk kishte ditur kurrë të na ledhatonte ne vajzat, dinte vetëm të merrte në fytyrë një shprehje turivarur dhe të zhdukej pas gazetës. Po me atë tren arriti edhe Koloneli, pasi që regjur në Luftën e Madhe dhe në ndeshjet në jug të vendit. Detyra e tij ishte të sillte rendin dhe disiplinën në tokat e shkreta nordike të lira dhe të egra. Unë nuk e mbaj mend, por Rebeka më tregoi që Koloneli dhe Fon Cshirski, që komandonte trupat gjermane, kishin dalë nga stacioni së bashku me ne dhe kishin biseduar me babanë gjatë gjithë rrugës deri në shesh, ku ishin bashkuar me paradën e gjermanëve. Babai dhe Koloneli kishin shumë gjëra të përbashkëta: në rini - futbollin, ideologjinë e Gardës së Bardhë, lëvizjen e jegërve, idenë e racës dhe, pas Luftës Çlirimtare, idealin monarkist. Babai mbeti shumë keq, kur Finlanda pas Luftës Çlirimtare nuk u bë monarki. Do të kishte dashur ta shihte Fridrih Karlin e Hesen-Kaselit mbret të Finlandës. Sipas tij, kjo do të ishte një mënyrë për ta bërë edhe më të fortë lidhjen ndërmjet nesh dhe Gjermanisë. Por populli finlandez nuk kishte lejuar të ndodhte kjo. Ishte manipuluar nga demokratët, që për të vendosur demokracinë kishin nxjerrë pretekstin se fronti gjerman kishte rënë në perëndim dhe Gjermania kishte humbur Luftën e Parë Botërore. Nuk kemi dashur kurrë të ishim me humbësit, por pikërisht me ta jemi rigjendur gjithmonë.

Rebeka më tregoi se pas marshit të mirëseardhjes kapteri Herman Suhlman kishte ngritur një kioskë në anë të sheshit të Olulut, midis kafazeve të pulave të Sutinenit dhe banakut të mjeshtrit Vikman që qepte rroba burrash sipas masës. Hermani kishte një sasi delikatesash që ne laponët nuk i kishim. Edhe unë, duke ndjekur Rebekën këmba-këmbës, vrapoja atje shumë herë gjatë ditës.

Në ato kohë na dukej sikur jetonim në parajsë. Sipas Rebekës, gjithë qyteti i Olulut çeli si një lule. Rebeka vallëzonte çdo mbrëmje në kazermën e zjarrfikësve e ndonjëherë edhe unë arrita të përgjoja nga porta e hyrjes. Mbaj